



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:020567

Datë: 31.03.2021

Numri i dokumentit: 01652198

C.nr.181/20

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** përmes gjyqtarit Blerim Beshtica, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses L. Z. V., me vendbanim në Fushë Kosovë, rr.‘...’, të cilën me autorizim e përfaqëson Malsore Halili, avokate nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi nga Gjilani, me objekt kontesti kompensim i shpërblimit jubilar, shpenzime të ushqimit dhe udhëtimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqjese, më datë 31.03.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L. Z. V.me vendbanim në Fushë Kosovë, rr.”Lidhja e Prizrenit”, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses në emër të kërkesës për kompensim të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune t’ia paguaj 50 % të një page bazë (421€) në shumë prej 210.5 €, në emër të emër të kërkesës për kompensim të shpenzimeve të ushqimit për 348 ditë pune nga 2 € në ditë t’ia paguaj shumën prej 696 €, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 348 ditë pune t’ia paguaj shumën prej 341.04 €, apo shumën e përgjithshme prej 1,247.54 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

**II. REFUZOHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses L. Z V, me vendbanim në Fushë Kosovë, rr.”Lidhja e Prizrenit”, e parashtruar kundër të paditurës Komunale Gjilanit, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për 348 ditë pune përtej shumës së aprovuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në shumë prej 341.04 €, pra, të njejtës i refuzohet shuma prej 1,071.84 €.

**III. APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesa e paditëses L. Z. V, me vendbanim në Fushë Kosovë, rr.”Lidhja e Prizrenit”, sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë në shumë prej 104 €, për pagesën e taksës taksës

gjqësore në shumë prej 32 €, për përfaqësimin e paditëses për dy seanca gjyqësore në shumë prej 270 €, apo në shumë të përgjithshme prej 406.20 €, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë, ndërsa **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesës së paditëses për shpenzimet e kërkuara për mbylljen e zyrës në shumë prej 33.8 €, për precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 80 €, dhe për kërkesën e parashtruar të paditurës në shumën prej 80 €.

## A r s y e t i m

Gjykata me qëllim që shqyrtimi gjyqësor të jetë sa më efikas dhe ekonomikisht i arsyeshëm, në përpjekje që procedura gjyqësore të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, e në bazë të propozimit dhe pajtimit të palëve ndërgjyqëse, dhe duke u bazuar në nenin 420 parag. 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK) ka vendosur që seanca për shqyrtim kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas asaj përgatitore.

### **Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

Paditësja L. Z. V me vendbanim në Fushë Kosovë, rr. "Lidhja e Prizrenit", përmes të autorizuarës së saj, Malsore Halili, avokate nga Vitia, më datë 11.02.2020 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, dhe shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit. Në padi ka theksuar se paditësja është e punësuar në SHFMU "Ramiz Cërnica" në fshatin Cërnica, Komuna e Gjilanit, në cilësi të mësime dhënëses, ku ende vazhdon të jetë në pozitë të njejtë të punës, me orar të plotë të punës, duke iu referuar dispozitave të Ligjit të Punës, përkatësisht nenit 55 të këtij ligji, dhe nenit 35 parag. 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit, si dhe pas shtrimit të mjeteve juridike në procedurë administrative pranë të paditurës, respektivisht pas parashtrimit të kërkesës në DKA, lidhur me realizimin e të drejtës së saj subjektive sipas kësaj çështje juridike kontestimore, dhe në mungesë të përgjigjes së dhënë nga DKA-së, ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që paditëses t'ia paguaj shpërbilimin jubilar prej 50 % të një page bazë, shpenzimet e ushqimit dhe shpenzimet e udhëtimit, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga data e inicimit të procedurës administrative, ndërsa me parashtruesen e datës 19.10.2020 e ka precizuar dhe plotësuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses dhe ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën që paditëses në emër të shpërbilimit jubilar t'ia paguaj shumën prej 210.5 € kurse në emër të shpenzimeve të ushqimit ka kërkuar t'ia paguaj shumën prej 696 € ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit ka kërkuar t'ia paguaj shumën prej 1,218 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,124.5 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga koha e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive, e me decidivisht si në padinë e parashtruar dhe parashtruesen për precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dhënë me shkrim lidhur me padinë e paditëses, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, pasi që e

njejta konsideron se kompetente për të vendosur sipas kësaj çështje juridike kontestimore është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, e jo Gjykata Themelore në Gjilan, për shka se e paditura konsideron se pavarësisht se a është përgjigjur apo jo në kërkesën e paditëses DKA-ja, respektivisht e paditura, paditësja ka pas mundësi që mbi bazën e përgjegjes së DKA-së, dhe për shkak të heshtjes administrative në afat ligjor ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamentit për Çështje Administrative. Tutje ka theksuar se paditësi kërkesëpadinë e tij e bazon në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës (në vijim: KKAK), të datës 18.04.2017 të miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejme: MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në tekstin e mëtejme: SBASHK), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 7 dhe pika 8 të kësaj kontrate, e sipas të paditurës kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit, si e paditur në këtë rast, sepse kjo kontratë nuk është në fuqi, pasi që Ligji nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i dt. 06 Maj 2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Si arsye tjetër ka cekur se Kontrata Kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës, i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, nga arsyeja se neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Pos tjerave ka theksuar se kontrata kolektive parasheh kompensimin për ditët aktive në punë dhe ky fakt mund të konstatohet duke marrë një vërtetim në shkollë mbi ditët e punës të mbështetur në ditarin e punës dhe në evidencat elektronike dhe se ky vërtetim duhet të jetë i nënshkruar nga drejtorit dhe sekretari i shkollës përkatëse ku punon paditësi, e që në rastin konkret paditësja me asnjë provë nuk e argumenton shumën e kërkuar për ditët e punës. Post ë cekurave më sipër ka shtuar se sipas nenit 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore, pra për të prodhuar efekt juridike, e njejta do të duhej të ishte regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur dhe në fund ka shtuar se nuk janë shtjerrë mjetet juridike sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së paditëses, e më decidivisht si në përgjigjen në padi.

E autorizuar e paditëses, në seancat gjyqësore të mbajtura më datë 22.01.2021 dhe datë 11.03.2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, kërkesëpadisë dhe precizimeve të deponuara në këtë gjykatë, duke shtuar se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune nga data 10.09.2020 dhe në kohën kur po mbahet ky shqyrtim gjyqësor, pra me datë 22.01.2021, e njejta i ka mbi 10 vite përvojë pune, më saktësisht 10 vite e 4 muaj, ndërsa lidhur me pretendimet e të paditurës se e paditësja nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me vendbanimin e paditëses, e njejta ka theksuar se në gjykatë i ka deponuar çertifikatën e martesës, çertifikatën e bashkësisë familjare, faturat komunale me anë të cilave dëshmohet se njejta jeton në Fushë Kosovë, ndërsa fakti që paditësja nuk ka sjellë dëshmi biletën e autobusit për çdo ditë nuk do të thotë që paditësja patjetër është dashur të udhëtoj me autobus, por se kompensimi duhet ti bëhet 70% të biletës së trafikut urban, pra nuk është kusht që patjetër të udhëtoj me autobus. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, e autorizuar e paditëses me parashtrësën tjetër, të datës 18.02.2021 e ka precizuar dhe plotësuar përsëri padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën që paditëses në emër të shpërbilimit jubilar për 10 vite

përvojë pune t'ia paguaj shumën prej 210.5 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 348 ditë pune t'ia paguaj shumën prej 1412.88 € dhe në emër të shpenzimeve të ushqimit për 348 ditë pune nga 2 € në ditë t'ia paguaj shumën prej 696 €, apo shumën e përgjithshme prej 2,319.38 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga koha e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive, e të cilin precizim të kërkesëpadisë gjykata e ka lejuar me aktvendimin procedural të datës 11.03.2021. Nga arsyet e cekura më lartë ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompenson, përkatësisht paguaj shpërblimit jubilar, shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e ushqimit, në shumat e cekura më sipër. Në fund të shqyrtimit gjyqësor e autorizuar e paditëses i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore, edhe atë: për kërkesën drejtuar DKA-së ka kërkuar shumën prej 80 €, për taksën gjyqësore ka kërkuar shumën prej 32 €, për përpilimin e padisë ka kërkuar shumën prej 104 €, për precizimin e padisë ka kërkuar shumën prej 80 €, për mungesën nga zyra ka kërkuar shumën prej 33.8 €, si dhe për dy seanca gjyqësore ka kërkuar shumën prej 270 €.

I autorizuari i të paditurës, gjatë seancave gjyqësore të mbajtura me datë 22.01.2021 dhe datë 11.03.2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjës në padi, duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe precizimin e të njejtës, nga arsyeja se pagat jubilarë sipas KKAK-së mund të realizohen pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesë është 30 ditë nga koha e të drejtës për kompensim. Pos kësaj, i njejtë gjatë kësaj seance ka shtuar edhe faktin tjetër se në rastin konkret paditësja ka 8 vite përvojë pune sipas listës së pagave dhe vërtetimit të lëshuar nga SHFMU "Ramiz Cërnica" me nr. protokollin 161, të datës 16.12.2019. Tutje ka theksuar se paditëses i konteston edhe shpenzimet e udhëtimit nga arsyeja se paditësja nuk ka ofruar dëshmi se ka pas shpenzime me rastin e udhëtimit, duke theksuar se për ta vërtetuar këtë fakt e njejtë mund të sjell certifikatën e vendbanimit dhe çmimin e biletës. Po ashtu paditëses ia ka kontestuar edhe përvojën e punës referuar vërtetimit të cilin e ka sjellur përfaqësuesja e paditëses me nr. protokollin 11, të datës 26.01.2021, për përvojë të punës, nga arsyeja se në këtë vërtetim ka vite të cilat janë llogaritur pas skadimit të afatit të KKAK, të datës 18.04.2017, pra pas datës 18.04.2020, duke shtuar se në parim si provë nuk e kundërshton e paditura, për shkak se ky vërtetim është lëshuar nga organet e të paditurës, mirëpo e njejtë e kundërshton bazën juridike për kërkesën e parashtruar nga e autorizuar e paditëses, pas skadimit të KKAK-së, konkretisht pas datës 18.04.2020, kjo ngase e paditura konsideron se sipas Ligjit të Punës, nenit 90, paragrafi 3 të këtij ligji, marrëveshjet kolektive mund të lidhen për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 vite. Pos tjerash, paditëses i ka kontestuar edhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit nga arsyeja se paditësja nuk ka ofruar dëshmi, apo prova relevante se a ka pas shpenzime me rastin e udhëtimit në relacionin për të cilin kërkon kompensimin. Në fund, i ka kundërshtuar edhe shpenzimet e kërkuara nga e autorizuar e paditëses, edhe atë, për precizimin e kërkesëpadisë, mbylljen e zyrës, kërkesën drejtuar DKA-së, dhe për një seancë gjyqësore, me arsyetim se këto shpenzime nuk janë obligative dhe të domosdoshme për procedurë, ndërsa sa i përket kërkesës për kompensim të shpenzimeve për precizimin e padisë i njejtë ka theksuar se e autorizuar e paditëses meqë është person profesionist ka mundur që me një parashtrësë inicuese të precizoj kërkesëpadinë e paditëses, kurse sa i përket kërkesës për kompensim të shpenzimeve për një seancë, respektivisht për seancën e shyer ka shtuar se e njejtë është shtyer me fajin e të autorizuarës së paditëses.

## **Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Formularin për kërkesë apo ankesë me nr. prtokolli ..., të datës 18.12.2019; Kërkesën drejtuar Drejtorisë Komunale në Arsim-Komuna Gjilan nga kërkuësja L. Z.V; Pagesën, respektivisht Listën e pagesave me nr. nëp. EM... për nëpunësin L. Z. V, Vërtetimin për përvojën e punës me nr. protokollin 161, të datës 16.12.2019 të lëshuar nga Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët “Ramiz Cërnica” në Cernicë dhe në paralelet e ndara fizike në Gumnishtë dhe Kravaricë; Vërtetimin për ditët e pranisë në punë me nr. protokollin ..., të datës 10.07.2020 të lëshuar nga Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët “Ramiz Cërnica” në Cernicë dhe në paralelet e ndara fizike në Gumnishtë dhe Kravaricë; Dëftesën e pagesës me nr. dok ... të datës 03.07.2020 të lëshuar nga Kompania Rajonale Pastrimi Prishtinë; Deklaratën për Bashkësinë Familjare me nr. serik F ..., nr. rendor 9/9001/2; Certifikatën e martesës me nr. serik M ..., nr. reference ..., nr. rendor ...; Vërtetimin për përvojën e punës me nr. protokollin ..., të datës 26.01.2021 të lëshuar nga SHFMU “Ramiz Cërnica” në Cernicë dhe paralelet e ndara fizike në Gumnishtë dhe Kravaricë; Ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. ser. E ... të lëshuar më datë 25.01.2021 nga Zyra e Gjendjes Civile në Fushë Kosovë; Vërtetimin e lëshuar nga SH.T.U “Anamarova” së bashku me Anex-I Çmimoren e datës 03.06.2020, dhe Vërtetimin e lëshuar nga Kompania e Transportit të Udhëtarëve “Fushë Kosova” SHPK.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga provat e administruara dhe nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse, ka konstatuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune të e paditura dhe e nejta ende punon të e paditura në punë dhe detyra të cekuar si më lartë. Po ashtu për palët ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues as fakti për ditët e pranisë në punë të paditëses të e paditura për periudhën e kërkuar, e po ashtu, nuk ishte kontestues as lartësia e kërkesëpadisë, mirëpo, si fakt kontestues ishte baza juridike e kërkesëpadisë, pasi që e paditura konsideron se nuk është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin nga KKAK nga arsytet e cekura në përgjigje në padi dhe nga deklarimi i palëve gjatë seancave të mbajtura.

Me provat e cekura më lartë, përkatësisht me Formularin për kërkesë apo ankesë, me nr. me nr. prtokolli ..., të datës 18.12.2019 dhe Kërkesën drejtuar Drejtorisë Komunale në Arsim-Komuna Gjilan nga kërkuësja L. Z.-V për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, shujtave ushqimore dhe pagave jubilar drejtuar DKA-Komuna Gjilan, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja paraprakisht ka kërkuar nga e paditura kompensimin e shpenzimeve për ushqim, rrugëtim dhe për shpërblim jubilar, por e paditura ka heshtur në lidhje me këtë kërkesë.

Nga Pagesa, respektivisht Lista e pagesave, nr. nëp. EM... për nëpunësin L. Z. V, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja pagën bazë e ka 421 €.

Nga Vërtetimi për përvojën e punës sipas nr. protokollit 161, i datës 16.12.2019, lëshuar Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “Ramiz Cërnica” në Cërnice dhe në paralelet e ndara fizike në Gumnishtë dhe Kravaricë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka përvojë pune në këtë shkollë 9 vite e 2 muaj, ndërsa nga Vërtetimi për ditët e pranisë në pune me nr. protokollin ..., i datës 10.07.2020, i lëshuar nga e njëjta shkollë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja si mësimdhënëse lëndore prej vitit 10.09.2010 e deri me 30.06.2020 përvojë pune ka 9 vite 2 muaj e 20 ditë, ndërsa nga data 18.04.2017 e deri me datë 11.03.2020 gjithsej ka 348 ditë pune, kurse nga Vërtetimi për përvojën e punës me nr. protokollin ..., i datës 26.01.2021, i lëshuar nga po e njëjta shkollë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja si mësimdhënëse lëndore prej vitit 10.09.2010 e deri me datë 26.01.2021, ka përvojë pune 10 vite 4 muaj e 16 ditë.

Nga dëftesa e Pagesës me nr. dok 50158, e datës 03.07.2020 e lëshuar nga Kompania Rajonale Pastrimi në Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se bashkëshorti i paditëses L. V është pagues i shërbimeve të mbeturinave në kompanin e cekur më lartë, ndërsa nga Deklarata për Bashkësinë Familjare me nr. serik F ..., nr. rendor ..., gjykata vërtetoi faktin se bashkëshorti i paditëses jeton në bashkësi familjare me paditësen L. Z. V dhe fëmijët N... dhe N. V në Fushë Kosovë, me adresë të vendbanimit rr. “...”, kurse nga Certifikata e martesës me nr. serik M ..., nr. reference ..., gjykata vërtetoi faktin se paditësja është e martuar me L. V, e nga Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. ser. E ... i lëshuar më datë 25.01.2021 nga Zyra e Gjendjes Civile në Fushë Kosovë, gjykata vërtetoi faktin se adresa e tanishme e paditëses është në Fushë Kosovë, rr. ‘....

Nga Vërtetimi dhe Anex-I Çmimorja e biletave (një drejtimëshe) të lëshuar nga SH.T.U “Anamorava” me datë 03.06.2020, gjykata ka arritur të vërtetoj faktin se kushton çmimi i biletave një drejtimëshe e transportuesve publik të udhëtarëve në pjesë të ndryshme të territorit të komunës së Gjilanit, duke përfshirë edhe në relacionet tjera në raport me komunat tjera, përkatësisht në realcinin Gjilan-Prishtinë, Gjilan-Viti, Gjilan-Ferizja etj.

Nga Vërtetimi për përvojën e punës me nr. protokollin ..., i datës 26.01.2021 i lëshuar nga SHFMU “Ramiz Cërnica” në Cërnice dhe paralelet e ndara fizike në Gumnishtë dhe Kravaricë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja si mësimdhënëse lëndore prej vitit 10.09.2010 e deri me datë 26.01.2021, ka përvojë pune 10 vite 4 muaj e 16 ditë.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga Kompania e Transportit të Udhëtarëve “Fushë Kosova” SHPK, gjykata vërtetoi faktin se çmimorja një drejtimëshe Fushë Kosovë-Prishtinë dhe anasjelltas kushton 0.40 €.

## **Baza juridike**

Me nenin 90 të Ligjit të Punës, është paraparë se: “1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:”1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj” ndërsa me nenin 4 parag.2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Po ashtu, sipas nenit 8, parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejme: LMD) është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”. Sipas nenit 35 parag.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është paraparë se: “Punënjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të një bilete të trafikut urban”, kurse me nenin 35 parag.7 të po kësaj kontrate është paraparë se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarëve, përmes restaurantit a kuzhinës, osë në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit”, ndërsa me nenin 35 parag. 8, pika 8.1 të po kësaj kontrate është paraparë se: “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej: për 10 vite të përvojës së punës në vlerë prej 50 % të një page bazë”, kurse me pikën 8.5 të po këtij neni parashihet se: “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse”.

## **Vlerësimi përfundimtar i gjykatës**

Pas administrimit të provave në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, pasi që me provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësja punon si mësimdhënëse në SHFMU “ Ramiz Cërnica ” në Cërnicë, ka përvojë pune mbi 10 vite, pagën e bazë e ka 421 € në muaj, ndërsa si ditë të pranisë në punë ka 348 ditë, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë, përkatësisht në nenin 35, parag. 7 dhe parag. 8, pika 8.1 dhe pika 8.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, gjeti se paditëses për shkak të përvojës së punës te e paditura mbi 10 vite i takon e drejta e kompensimit për shpërblimin jubilar në vlerë të 50 % të një page baze, ashtu që duke llogaritur 50 % të pagës bazë sa e ka paditësja në shumë prej 421 € (421x50%=210.5) të njejtës i takon shpërblimi në shumë prej 210.5 € (shumë

kjo e aprovuar nga gjykata), ndërsa në emër të kërkesës për kompensim të ushqimit për 348 ditë të pranisë në punë, gjykata gjeti se paditëses i takon e drejta e kompensimit të ushqimit nga 2 € në ditë për ushqim gjatë ditëve në punë, ashtu që paditëses për 348 ditë të pranisë në punë, llogaritur nga 2 € për një ditë ( $348 \times 2 = 696$ ) i takon shuma prej 696 euro.

Gjykata duke u bazuar në nenin 35 parag. 5 të KKAK ka vendosur që paditëses t'ia aprovoj pjesërisht kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për 348 ditë pune, ashtu që të njejtës i ka aprovuar vetëm shumë prej 341.04 €, ndërsa pjesën tjetër përtej kësaj shume të gjykuar ia ka refuzuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak se me provat e administruara, sidomos me çertifikatat e cekura më lartë dhe Anex-I çmimorjen e biletave (një drejtimshme) gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja udhëton nga Fushë Kosova për te vendi i punës ku punon në fshatin Cërnicë, mirëpo gjykata të njejtës ia ka aprovuar vetëm shpenzimet e udhëtimit brenda territorit të komunës së Gjilanit, edhe ate 70 % të shpenzimeve të udhëtimit nga fshati Bresalc, deri te vendi i punës së paditëses, në këtë rast në fshatin Cërnicë, kjo pasi që me nenin 35 parag. 5 të KKAK në mënyrë shprehimore është përcaktuar se: *“Punëtorët arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletës së trafikur urban”*, andaj në interpretim të kësaj dispozite, gjykata paditëses nuk ia ka aprovuar 70 % të shpenzimet të udhëtimit jashtë komunës së Gjilanit, në këtë rast i ka refuzuar kërkesën për kompensim të shpenzimeve nga Fushë Kosova deri te vendi i punës së saj në fshatin Cërnicë, pasi që me këtë dispozitë në mënyrë të qartë është cekur se punëtorëve arsimor i paguhen 70 % të biletës së trafikut urban në vendbanimet e komunës së caktuar. Sa i përket lartësisë së shumës së aprovuar për këtë kërkesë në shumë prej 341.04 €, gjykata është bazuar në Anex-I çmimorjen e cekur më lartë, pasi që nga kjo provë rezulton se çmimi i biletës në dy drejtimet për shkuarje ardhje në punë nga relacionin Bresalc–Cërnicë (vende këto në kuadër të komunës së Gjilanit) kushton 1.40 €. Prandaj, gjykata gjeti se paditëses për dy drejtimet e udhëtimit në relacionin Bresal-Cërnicë, për 348 ditë pune, duke llogaritur nga 1.40 € për një ditë shpenzime të udhëtimit, të njejtës i takon 70 % e kompesimit të shpenzimeve të udhëtimit ( $348 \times 1.40 \times 70\% = 341.04$  €) apo shuma prej 341.04 €, andaj edhe vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi .

Gjykata e ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës lidhur me kundërshtimin e kompetencës lëndore të kësaj gjykate, mirëpo gjykata vlerëson se kjo çështje juridike është në kompetencë të Gjykatës Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, e jo në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, pasi që të drejtat dhe detyrimet dhe raportet në mes palëve ndërgjyqëse janë të rregulluara me Ligjin e Punës, e rrjedhimisht edhe me KKAK-në. Për më tepër sipas nenit 2 par. 2 të Ligjit të Punës, në mënyrë shprehimore është cekur se: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”*, e në rastin konkret ligjet e veçanta të cilat e rregullojnë këtë fushë nuk kanë paraparë ndonjë mënyrë tjetër të zgjidhjes së kontesteve për këtë kategori të të punësuarve, e rrjedhimisht për vendosjen e këtij kontesti në mes palëve ndërgjyqëse është e kompetencës lëndore kjo gjykatë. Për më tepër, gjykata gjatë gjithë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore dhe nga



arsyet e cekura më lartë vlerëson se kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të vendosur për këtë çështje kontestimore.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës ku ka cekur se KKAK nuk prodhon efekt juridik për të paditurën, ngase sipas vlerësimit të gjykatës një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës me nr.03/L-068, ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre, e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me kontratë bien në barrë të të paditurës. Pos tjerash, gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pabazuar edhe nga fakti se KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të Ligjit të Punës (nenin 90 i këtij Ligji), e po ashtu edhe me dispozitën e nenit 2 të kësaj kontrate është paraparë se dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar ku bënë pjesë edhe paditësja. Pastaj është caktuar qartë se dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, gjegjësisht komunat-DKA-të, ku në këtë rast është e paditura (neni 2 i KKAK-së). Nga këto arsye, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga KKAK, pasi që kjo kontratë është lidhur në nivel vendi dhe në pajtueshmeri me dispozitat e Ligjit të Punës.

Sa i përket pretendimit tjetër të paditurës ku ka theksuar se KKAK nuk është regjistruar fare në faqen MPMS, dhe si e tillë nuk duhet të prodhoj efekt juridik, po ashtu, gjykata një pretendim të tillë nuk e mori për bazë, sepse sipas vlerësimit të gjykatës nuk është relevante se a është regjistruar apo jo KKAK në faqen e MPMS, sepse referuar nenit 47 të kësaj kontrate është paraparë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, e njëjta regjistrohet dhe depozitohet në MASHT e jo në ndonjë organ tjetër siç pretendon e paditura, kjo për faktin se kjo kontratë është sektoriale dhe jo e përgjithshme, dhe e njëjta prodhon efekt juridik vetëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin e arsimit (neni 2 i KKAK). Sido që të jetë, akti i regjistrimit dhe depozitimi i kontratave, sikurse kjo në rastin konkret i KKAK-së ka qenë, përkatësisht është përgjegjësi e karakterit administrativ e organit publik kompetent që të njëjtën ta regjistroj apo depozitoj, e për të cilat lëshime eventuale nuk mund të kenë konsekuenca të punësuarit, e në këtë rast nuk mund të pësoj paditësja.

Lidhur me pretendimin e të paditurës ku ka theksuar se paditësja fillimisht nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi në gjykatë, për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, pasi që me provat e administruara, përkatësisht me Formularin për kërkesë apo ankesë me nr. protokoli ..., të datës 18.12.2019 dhe Kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, shujtave ushqimore dhe pagave jubilarë drejtuar DKA-Komuna Gjilan nga paditësja, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja fillimisht iu ka drejtuar të paditurës me kërkesë për realizimin e të drejtave të saj nga marrëdhënia e punës, mirepo të drejtën e saj në procedurë administrative nuk ka mundur ta realizoj dhe si rrjedhojë me kërkesë iu ka drejtuar gjykatës për realizimin e të drejtave të saj nga marrëdhënia e punës. Përveç të cekurave, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, meqë e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventat ndërkombëtare dhe me ligj, në rastet e paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që

paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, pasi që sipas nenit 87 të Ligjit e Punës, është përcaktuar qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Nga kjo dispozitë del pa mëdyshje se afati për ngritjen e padisë lidhur me kërkesat në të holla është afati 3 vjeçar dhe parashtrimi i padisë në gjykatë pas këtij afati është kërkesë e parashkruar, mirëpo kjo nuk nënkupton se paditësi nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerrur mjetet juridike të e paditura ashtu siç pretendon e paditura, kjo ngase e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditëses në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet dhe kundërshtimet e të autorizuarit të paditurës të cekura gjatë seancës së mbajtur me dt.22.01.2021 se paditëses nuk i takon kompensimi për shpërblimin jubilar, pas datës 18.04.2020 për ditët e llogaritura pas skadimit të afatit të Kontratës Kolektive, ditë këto të llogaritura sipas Vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “Ramiz Cërnica” në Cërnice me nr.protokollit ..., të datës 26.01.2021, mirëpo gjykata ka gjetur se një pretendim i tillë i të paditurës nuk qëndron, për shkak se me nenin 45 të KKAK shprehimisht thuhet se: *“Nga Kontrata Kolektive, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t'i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për 1 vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive, lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmuorin e parë përdoren rregullat dhe dispozitat e kontratës së vjetër”*, e në rastin konkret përderisa nuk kemi kontratë të re të nëshkruar nga palët ndërgjyqëse dhe nuk kemi tërheqje nga Kontrata Kolektive të asnjërës palë, bazuar nga neni i lartcekur i Kontratës Kolektive, mund të përfundohet se dispozitat e kësaj kontrate janë akoma në fuqi dhe kjo kontratë prodhon efekt juridik për palët kontraktuese, deri në nxjerrjen dhe nënshkrimin e kontratës së re kolektive apo siç është cekur më lartë zbatimi i saj vazhdon edhe për 1 vit.

Duke pas parasysh faktin se paditëses i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së saj lidhur me kërkesën e parashtruar, e njëjta si palë që është legjitimuar ka të drejtë që të kërkojë përmbushjen e detyrimit të cekur më lartë nga e paditura, pasi që me nenin 245 të LMD-së në mënyrë shprehimore është paraparë se: *“Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, andaj, duke pas parasysh të cekurat më lartë, gjykata gjeti se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditëses, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shumën e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të LMD-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata duke pas parasysh suksesin në procedurë të paditëses dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463 parag.1 të LPK-së, dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, ka aprovuar pjesërisht kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga e autorizuar e paditëses, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë, për përpilimin e padisë në shumë prej 104 €, për pagesën e taksës taksës gjyqësore në shumë prej 32 €, për përfaqësimin e paditëses për dy seanca gjyqësore në shumë prej 270 €, apo shumën e përgjithshme prej 406.20 €, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë, ndërsa i ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesës për shpenzimet e kërkuara për mbylljen e zyrës në shumë prej 33.8 €, për precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 80 €, dhe për kërkesën e parashtruar të paditurës në shumë prej 80 €, ngase shqyrtimi gjyqësor nuk është inicuar me këtë parashtrësë dhe as nuk ka qenë e nevojshme për inicim të kërkesëpadisë, sepse kërkesëpadia nuk ka qenë e varur prej kërkesës drejtuar DKA-së, e po ashtu ka refuzuar edhe shpenzimet për shkak të mungesës së të autorizuarës së paditëses në zyrë të saj në shumë prej 33.8 € dhe për parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 80 €, kjo nga arsyeja se këto shpenzime nuk bëjnë pjesë në shpenzime të nevojshme referuar nenit 453 të LPK-së, pasi që parashtrësja për precizimin e kërkesëpadisë është bërë para caktimit të shqyrtimit gjyqësor, andaj gjykata vlerëson se ky shpenzim nuk mund t'i vihet në barrë të paditurës, sepse e njëjta nuk i ka dhënë shkas paditësit për të precizuar kërkesën e tij, ndërsa sa i përket pjesës tjetër për shpenzimet për mungesë nga zyra të avokates, gjykata vlerëson se këto nuk bëjnë pjesë në shpenzime të procedurës gjyqësore, pasi këto shpenzime nuk janë paraparë me nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, e po ashtu nuk bënë pjesë në shpenzime të procedurës kontestimore të shkaktuar gjatë këtij procesi gjyqësor.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr. 181/20, me datë 31.03.2021**

**Gjyqtari,**  
**Blerim BESHTICA**

**UDHËZIMI JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:020567  
Datë: 31.03.2021  
Numri i dokumentit: 01652198